



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.1396/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit, Adol shpk me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, të cilin me autorizim, e përfaqëson Naser Peci avokat nga Prishtina, kundër të paditures Elkos shpk me seli në Pejë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A.A. dhe ndërhyrësit në procedurë Kantina Gjergj Kastrioti Skëndërbeu SHA, me seli në Durrës Republika e Shqipërisë, për shkak të shkeljes së markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.430/2022 të datës 07.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit Adol shpk me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.430/2022 i datës 07.04.2023, Vërtetohet

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në vijim: I.Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Adol shpk me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri Elkos shpk dhe ndërhyrësi në procedurë Kantina Gjergj Kastrioti Skëndërbeu SHA, me seli në Durrës Republika e Shqipërisë, me datën 11.08.2017 duke importuar dhe tregtuar, një sasi prej 1200 shishe “brandy” 700ml, dhe me datën 28.08.2017 duke importuar 7800 shishe pije alkoolike, nga të cilat 2400 shishe “brandy” 700ml, 1800 shishe “brandy”, 500ml dhe

3600 shishe “brandy”, 200ml, ka shkelur markat tregtare të paditësit sipas numrave të regjistrimit 8230,9231,8253,17665 dhe 19376, si dhe të i ndalohe të paditurit dhe nderhyrësit që në të ardhmen të vë në qarkullim në Republikën e Kosovës produktet “Dyrrah” brandy, të cilat përmbajnë shkelje të markave tregtare në pronësi të paditësit, të urdherohet i padituri dhe nderhyrësi që produktet ti shkatërrojne me shpenzimet e tyre dhe vendimi përfundimtar i gjykatës të publikohet në mjetet e informimit publik të Kosovës, me shpenzimet e të paditurit dhe ndërhyrësit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 4,032.00€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga pranimi i aktgjykimit nën kërcnim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij Aktgjykimi, ka paraqitur ankesë i autorizuari i palës paditëse, Naser Peci avokat në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore-civile, zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e paditësit, të Ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe të aprovohet kerkespadia e paditësit në tërsi si e bazuar, dhe të detyroj të paditurin të paguaj shpenzimet përfshirë edhe të ankesës ose aktgjykimin ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi Adol shpk me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, ka ushtruar në gjykatë, padi kundër të paditurit Elkos shpk me seli në Pejë, për shkak të shkeljes së markës tregtare, dhe ka këkruar nga gjykata që të aprovohet në tëtrsi si e bazuar kerkespadia e paditësit, të vërtetohet se i padituri Elkos shpk, ka shkelur markën tregtare të paditësit me numer regjistrimit 8230-etiketa ngjyrë zi, ari, shenjat emblema e Kastriotëve dhe medalja e bronzte me numer regjistrimit 8231 emri i stilizuar “Skëndërbeu” nr.17665 dhe nr.19376 emblema e Kastriotëve me ngjyrë kuq, zi, ari me importim dhe vënie në treg në territorin e Kosovës së produktit “Dyrrah”, të urdherohet i padituri që nga stoqet dhe tregu të heqë të gjitha sasi të “Dyrrah” në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të aktgjykimit nën kërcnim të përmbarimit të detyrueshëm.

Paditësi përmes përfaqësusit të autorizuar gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare kërkon që të aprovet padia e paditësit si e bazuar dhe të vërtetohet se i padituri Elkos shpk dhe ndërhyrësi në procedurë Kantina Gjergj Kastrioti Skëndërbeu SHA, ka shkelur markën tregtare. Markat tregtare të paditësit janë të regjistruara dhe si të tilla gëzojnë mbrojtje nga secili shkelës eventual. Më tutje paditësi shton se shenjat e ngjashmërive në mes markave të paditësit dhe produkteve të importuara nga i padituri nuk mund të vlersohen vetëm mbi bazën e një krieteri qoftë ai i shqiptimit apo emrit, por ngjashmëria duhet të vlersohet si tërsi, duke marrë për bazë konceptin e zgjidhjes dizajnore si dhe llojet e produktit. Nga provat e administruara është vërtetuar se i padituri me importin e mallrave objekt i kontestit, ka bërë shkelje për faktin se produktet e importuara kanë shenja dhe ngjashmëri me markat e mbrojtura. I propozon gjykatës që ta aprovoj kërkespadin si të bazuar dhe i kërkon shpenzimet procedurale në shumën prej 4,032.00€.

I padituri përmes të autorizuarës së tij, në seancat gjyqësore ka kundërshtuar në tërsi kërkespadin e paditësit, duke shtuar se produkti “durrah” është tërsisht i ndryshëm nga markat tregtare të regjistruara në emër të paditësit, ashtu siq edhe ka konstatuar Gjykata e Apelit me aktvendimin Ae.nr.11/2019. Dallimet në mes produktit të paditësit dhe të paditurit dallojnë si në pamje, si në shqiptimin e shenjës, në konceptin e paraqitjes së shenjave në dizajn grafik dhe përceptimin e konsumatorit mesatar. Duke marrë parasysh që produktet në fjalë nuk kategorizohen në produktin e konsumit të përditshëm dhe nuk përdoren nga secili qytet i rëndomtë, por vetëm nga konsumuesit e rritur mbi 18 vjet, të vetedijshëm të cilët kanë njohuri të mjaftueshme për të dalluar produktin e paditësit nga produktet e tjera të ngjashme edhe mundësia e shkaktimit të konfuzionit ndërmjet produktit të paditësit dhe të paditurit nuk ekziston dhe për të konsideruar se këto dy marka janë plotësisht të njëjta dizajni, kombinimi i ngjyrave, përshkrimi në amabalazh. I ka propozuar gjykatës që kërkespadinë e paditësit ta refuzoj si të paabzuar, shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë pas marrjes së aktvendimit nga Gjykata e Apelit Ae.nr.1/2019 datws 06.02.2019, në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 09.03.2023 në prani të

përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, pas administrimit të provave, ka marr Aktgjykimin e atakuar me të cilin ka refuzuar si të pabazuar kërkespadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata referohet ne dispozitën e nenit 8 të Ligjit 04/L-026 për Markat Tregtare i cili përcakton shkeljet e markës tregtare. Gjykata iu referu kriterëve themelore për vlersimin e ngjashmërisë së shenjave në fjalë dhe nga shkalla e ngjashmërisë vizuale, aurale, si dhe shkallën e ngjashmërisë së konceptuar, nga provat e administruara dhe fodokumentacioni, gjeti kërkespadia e paditësit është e pabazuar. Gjykata vlersoi se në mes produkteve të padiësit dhe produkteve të paditurit ekziston një dallueshmëri e theksuar në fon të shkronjave të përdorura, të dhënat e prodhuesit, marka tregtare e ndërhyrësit përmban fjalën “brandy” nën emrin “dyrrah” e cila nuk gjendet te marka e paditësit dhe vulën e qytetit të Durrësit, ndërsa marka e paditësit përmban vulën me “Kalanë e Skëndërbeut në Krujë”. Gjykata vlersoi se kërkespadia e paditësit për vërtetimin e shkeljes së markës tregtare nga i padituri, nuk ka mbështetje ligjore andaj refuzon kërkespadin e paditësit.

Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, i vlerësoi të pabazuara në ligj, pretendimet ankimore se në procedurë ka provuar faktin se në tapën e produkteve të paditurit janë përdor ngjyrat kuq e zi dhe e artë, emri Gjergj Kastrioti Skëndërbeu, emri i stilizuar “Skëndërbeu” stema heraldike e Katriotëve”, shenja këto që në esenc përmbanjnë edhe markat e paditësit, pastaj paditësi ka provuar se produkti i të paditurit me emrin “Dyrrah” përmban shenja që në përgjithësi janë me ngjashmëri thelbësore me markat e paditësit si në amabalazh ashtu edhe në paketim, pra produkti “dyrrah” shkel markat tregtare të paditësit ngase ka ngjashmëri thelbësore me shenjat që kanë markat e paditësit, është fakt se emri i produktit të paditurit ndryshon nga marka e regjistruar verbale e paditësit por

ky element nuk do duhej të ishte përcaktues për refuzim të kërkespadise sepse duhet të vlersohet ngjashmëria e markës në përgjithësi. Mbi bazën e nenit 8 të LMT-së, paditësi konsideron se gëzon të drejtën të kërkojë mbrojtje për markat e regjistruara nga momenti i regjistrimit të markave.

Kolegji i shqyrtoi të gjitha këto pretendime ankimore të paditësit, mirepo nga provat e administruara, fotodokumentacioni i produkteve kontestuese të markës tregtare të mbrojtur, dispozitave ligjore në fuqi që përcaktojnë mbrojtjen e produktit të markës së regjistruar nga markat tjera identike, nuk ka gjetur se i padituri ka shkelur markën tregtare “Skëndërbeu” të paditësit, duke tregtuar apo importuar produktin identik “Dyrrah” brandy me produktin e paditësit, të regjistruar me numrin 8230,8231,8253,17665 dhe 19376 në territorin e Republikës së Kosovës.

Kolegji, vleroi se me të drejtë gjykata e shkallës së parë është referuar në dispozitën e nenit 8 të Ligjit që ka qenë në fuqi nr.04/L-026 për Markat Tregtare, e cila dispozitë i jep të drejtë pronarit të markës tregtare të ndalojë palët e treta ta përdorin pa lejen e tij qdo shenje që është identike me markën e produkteve të tij të regjistruara. Në rastin konkret Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, vleroi se nuk është i saktë dhe nuk gjen bazë ligjore pretendimi i paditësit se produkti i të paditurit me emrin “Dyrrah” përmban shenja që në përgjithësi janë me ngjashmëri thelbësore me markat e paditësit si në amabalazh ashtu edhe në paketim, pra produkti “dyrrah” shkel markat tregtare të paditësit. Edhe Kolegji vleroi se ekzistojnë dallime të mëdha ndërmjet markave tregtare të paditësit “Gjergj Kastrioti Skëndërbeu” dhe markave të përdorura nga i padituri si në aspektin vizual, shenjave në dizajn grafik, vula e qytetit të Durrësit.

Kolegji, vleron se pretendimet e paditësit nuk gjejnë mbështetje ligjore për tu konstatuar shkelja e markës tregtare e produktit “dyrrah” brandy, dhe në këtë rast nuk është vërtetuar propozimi i paditësit, se e paditura ka tregtuar me produkte të cilat shkelin markën tregtare të paditësit. Gjithashtu Kolegji, gjen se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat materiale të Ligjit për Markat Tregtare. Në këtë rast paditësi nuk ka mund të sigurojë bazueshmërinë e kërkesës së tij për tu konstatuar se e paditura ka shkelur markën tregtare të produkteve të regjistruara.

Kolegji, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt faktet dhe në bazë të dispozitave ligjore, ka vërtetuar se paditësi nuk ka ofruar prova të bazuara se i padituri ka shkelur markën tregtare të paditësit.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga sa u parashtrua e në mbështetje të dispozitës së nenit 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1396/23 datë 28.03.2024

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,

Krenar Berisha